



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE-ANASTAVSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Nivela Org. Org. Jecinika Org. Unit	01	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot.No:	6016
Nr. I faqeve Broj. stranic No. of pages	2	Data Datum Date	08.09.2020
Prishtinë / g			

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit-Kabinet Ministra-Cabinet of the Minister

01.Ref.Nr.04
Prishtinë,08.09.2020

Ministri i Ministris së Tregtisë dhe Industrisë ,në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1 .4. shtojca 13 e Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Vendimi nr. 01/09, datë: 13.03.2020, merr:

URDHËRESË

Për shtyrjen e shërbimeve turistike

1.Urdhërohen subjektet turistike që përmes kuponëve (vouchers) ose dokumenteve të barasvlershme t'u mundësojnë ;

1.1. Shtyrjen deri me 31 dhjetor 2021 të shërbimeve turistike të parapaguara ose të rezervuara turistëve të cilët nuk kanë mundur të udhëtojnë për shkak të pandemisë COVID-19, në marrëveshje me konsumatorin;

1.2. Zëvendësimin e paketave me paketa të cilësisë së njëjtë ose më të lartë konsumatorëve të cilëve u janë anuluar paketat turistike për shkak të pandemisë COVID-19; dhe nëse paketat zëvendësohen me paketa të cilësisë më të ulët t'ua kthejnë dallimin në çmim;

1.3. Bartja e të drejtave nga personat që nuk mundën të udhëtojnë tek personat e tjerë duhet të bëhet me marrëveshjen e palëve;

1.4. Me hyrjen në fuqi të kësaj urdhërese shfuqizohet urdhëresa me numër të protokollit 2241 datë 18.05.2020.

2. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vesel KRASNIQI

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Turizmit;

- *Departamentii Ligior;*
- *Arkivi .*